

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, sekretaren juridike Sanije Troshupa, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit F.O, nga P, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6715/2015, dt.14.01.2016, dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë **03/02/2017**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6715/2015, dt.14.01.2016, kjo Gjykatë i jep këtë;

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

F.O, nga i ati A, e ëma M, e gjinisë M, i lindur me datën *data e lindjes* në P, ku edhe tani jeton në rrugën "...", p.nr., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, me profesion kuzhinier, me numër personal *numer personal*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datë 03/11/2015, rreth orës 01:25 minuta, gjatë kontrollës së veturave në rrugën "...", në P, te i dyshuari është gjetur një qese me bari me ngjyrë të gjelbërt – substancë narkotike e llojit mariuhanë, me peshë të përgjithshme prej 1.09 gram, të cilën i pandehuri e ka poseduar pa autorizim.

- **Më këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 42, 43, 46,73, të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 dhe nenit 495 të KPRK-së, të pandehurit i :

S H Q I P T O N

DËNIM MË GJOBË në shumë prej **200.00 € (dyqindë euro)**, të cilin dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veproj në bazë të nenit 46 të KPRK-së, deri në zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg shumë prej 20 (njëzetë) €.

Në mbështetje të nenit 275 par.3 të KPRK-së, lidhur me nenin 282 par.2 pika 2.4 të KPPRK-së – **URDHËROHET** - konfiskimi i përhershëm i substancave narkotike të llojit “Mariuhanë”, me peshë të përgjithshme prej 1.09 gram, të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen nga Policia e Kosovës.

I pandehuri obligohet që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.6715/2015, dt.14.01.2016, po ashtu me të njëjtën datë është parashtruar edhe kërkesa për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, kundër të pandehurit F.O, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar në bazë të nenit 495 të KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e të pandehurit se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë sipas Aktakuzës së Prokurorit të Shtetit.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohet nga provat si vijojnë dhe atë: nga kallëzimi penal i policisë me numër të rastit 2015-AC-1434, dt.09/11/2015, raporti i ekspertizës së Agjensisë së Kosovës për Forenzikë, me numër referues AKF/2015-4155/2015-3392 e datës 29/06/2015, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit F.O i datës 03/11/2015, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit F.R i datës 03/11/2015, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshme të sendeve, si dhe foto dokumentacioni, të gjitha këto vërtetojnë veprimet në kuptim të veprës penale me të cilën akuzohet i pandehuri.

Sipas KPRK-së, për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, dënimi për këtë veprë penale është se kryerësi dënohet me dënim me gjobë apo burgim deri në një (1) vit.

Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-se, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, vlerësoj rrethanat në matjen e dënimit, duke vlerësuar se një dënim i tillë është adekuat dhe është i përballueshëm në raport me gjendjen e tij ekonomike dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 të KPRK-ës dhe se i pandehuri do të përmbahet dhe do të ketë sidomos kujdes të shtuar që në të ardhmen të mos bie në kundërshtim me ligjin.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori konform nenit 450 të KPP-ës.

Vendimi mbi konfiskimin e substancave narkotike bazohet në nenin 275 par.1 të KPRK-së lidhur me nenin 282 par.2 pika 2.4 të KPPRK-së.

Nga theksimet e theksuara si me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.201/2016 dt.03/02/2017

Sekretarja juridike
Sanije Troshupa

Gjyqtari
Rrustem Begolli

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi pala ka të drejtë kundërshtimi, në afat prej 8(tetë) ditësh,nga dita e pranimit, kundërshtimi i parashtrohet kësaj gjykate.